



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 15-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 27.04.2023, në sallën numër 1, kati i 3-të, me fillim në ora 14⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Anila Reqica-Llugiqi DKRS
2. Safete Amerllahu, DGJK
3. Latif Ramadani, DBF
4. Burim Rrustemi, DSHPMSh

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës e keni marrë me kohë, dhe e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 17-të e Kuvendit.
2. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Mars 2023.
3. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare (Momoramdum, bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "Qatar Charily").
4. Propozim Vnedimi për miratimin e nismës së Kryetarit të Komunës për Hyrje në bashkëpunim ndër-komunal.

5. Propozim Rregullore për orarin e punës së veprimtarive ekonomike në teritorin e Komunës së Lipjanit.
6. Propozim Vendimi për zëvendësimin e anëtares së Komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore në Komunën e Lipjanit për vitin shkollor 2022-2023.
7. Propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullorës për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit.
8. Propozim Vendimi për zëvendësimin e antarës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi- KKSBB-së.
9. Informatë për raportin vjetor financiar 2022, të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave KPM "Pastrimi" Sh.A.

Pastaj tha se pikën 2 dhe pikën e 9-të po e dërgojme direkt për kuvend

Pasi që nuk pati plotësime as vërejtje, kryesuesi të njëjtin e vuri në votim rendin e ditës ,pastaj u konstatua se me të gjitha votat, 7 për, aprovoi rendin e ditës:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 14-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për:

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 14-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës

III

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare (Momoramdu, bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës “Qatar Charily”).

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rexhep Rexhepit drejtori i DB i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Egzona Bytyqi, tha se deri kur do të zgjatë ky bashkëpunim me këtë organizatë, a keni ndonjë datë të caktuar?

Rexhep Rexhepi, tha se varet se çfarë projekte kanë. Ky projekt do të zgjatë vetëm për këtë vit.

Meqë diskutime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IV

Propozim Vendimi për miratimin e nismës së Kryetarit të Komunës për Hyrje në bashkëpunim ndër-komunal.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia kaloi fjalën Rexhep Rexhepit, nga DBPZHVR i cili i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se pse nuk është përfshirë edhe komuna e Drenasit në këtë nismë.

Rexhep Rexhepi tha se kjo ka qenë një nismë e kryetarit të Prishtinës dhe është përfshirë vetëm religjioni i Prishtinës.

Egzona Bytyq, tha se a ka mundësi që edhe ne të kemi ndonjëherë ndonjë bashkëpunim me ndonjë komunë çdo te ishte e mire te bëhej diçka edhe nga komuna jonë?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që raporti t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

V

Propozim Rregullore për orarin e punës të veprimtarive ekonomike në teritorin e Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit nga DEZH, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se për barnatoret te cilat kanë leje për punë 24 orë, a keni drejt ti ndalni me këtë rregullore. Pasi që unë kam frikë që kjo rregullore do të na kryhet negativ nga ministria.

Valon Pacolli, tha se këtë e kemi bërë ne bashkëpunim me inspektorët e tregut.

Alban Salihu, tha se është mirë te video lojërat te ju lejohet te punojnë edhe ditëve të diel pasi që shumica prej tyre janë biznese familjare nuk kanë punëtor

Daut Azemi, kryesues i komitetit tha se ne edhe në dëgjim publik jemi munduar me dhënë kontributin por nuk është që ka pas shumë interesim për këtë rregullore.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VI

Propozim Vendimi për zëvendësimin e antarës së Komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore në Komunën e Lipjanit për vitin shkollor 2022-2023.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit, nga DKA, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VII

Propozim Rregullorë për ndryshimin dhe plotësimin e rregullorës për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasaniot, nga DKA i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Arsim Jashari, tha se këta studentë nuk është dashtë të mbeten pa bursë është dashtë që te ju gjendet një zgjidhje dhe te stimulohen, unë nuk do ta përkrahi këtë propozim. Ligji është për të gjithë njëjtë dhe nuk duhet te diskriminohen

Albiona Tahsolli, tha se unë mendoj që më shumë duhet te stimulohen studentët që studiojnë në vendin tonë pasi që këta kanë nevojë për stimulim.

Alban Salihu, tha se a ka pas interesim për bursë nga studentët që studiojnë jashtë shtetit dhe sa ka qenë numri i tyre.

Egzona Bytyqi, sa ka qenë numri i studentëve të cilët kanë përfituar bursë me automatizëm?

Rasim Hasani, tha se ne nuk po kemi mundësi se si te ju ndihmojë këtyre studentëve pasi që nuk po dimë si ti vlerësojmë. Ka pas numër diku 8 apo 9 studentë që studiojnë jashtë që kanë aplikuar për bursë . Një studentë ka qenë që ka përfituar me automatizëm.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VIII

Propozim Vendimi për zëvendësimin e antarës së Kshillit Komunal për Siguri në Bashkësi- KKSB-së.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15:15

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi